



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA

SHKOLLA SHQIPTARE E ADMINISTRATËS PUBLIKE  
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

## RAPORTI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT JANAR – GUSHT 2023

Në zbatim të pikës 270 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” të ndryshuar si dhe të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike për periudhën Janar-Gusht 2023, ka administruar dhe menaxhuar fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit për vitin 2023.

Gjatë periudhës Janar-Gusht 2023, përdorimi i fondeve buxhetore është bazuar në respektimin korrekt të planit të buxhetit për vitin 2023 të miratuar, sipas programeve, artikujve, kapitujve në lidhje me pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimet operative, investimeve të brendshme, duke siguruar një menaxhim dhe përdorim të fondeve buxhetore me transparencë, eficiencë dhe efektivitet të plotë.

Për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike buxheti plan i alokuar për vitin 2023 është 55.937.000 lekë në total. Konkretisht është i shpërndarë në zërat si më poshtë:

- 53.937.000 lekë janë Shpenzime Korrente nga kapitulli 01 dhe kapitulli 05.
- 2.000.000 lekë Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm.

Nga zërat më me peshë të buxhetit për periudhën Janar-Gusht 2023, përfshihen shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative si dhe projektet e investimeve.

- **Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore** (zërat 600+601) janë realizuar në zbatim të strukturës së institucionit, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.56, datë 01.02.2023 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në njësitë e qeverisjes qendrore”. Në këto zëra, janë reflektuar ndryshimet e bëra sipas Vendimit nr.325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”

**SHKOLLA SHQIPTARE E ADMINISTRATËS PUBLIKE**

dhe Vendimit nr.326, datë 31.5.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”. Struktura e ASPA-s ka ndryshuar gjatë kësaj periudhe raportuese, në bazë të Urdhrit të Kryeministrit me nr.87, datë 26.07.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Shkollës Shqiptare të Administratës Publike”.

Shumat e alokuara në buxhetin vjetor janë përkatësisht 25.357.000 lekë për zërin 600 dhe 4.380.000 lekë për zërin 601. Shumat e realizuara për periudhën 8-mujore të raportimit janë përkatësisht 14.029.576 lekë për zërin 600 dhe 2.345.314 lekë për zërin 601, që përkthehen respektivisht në 55.3% dhe 53.5% ndaj totalit të alokuar për secilin zë.

- **Fondi për shpenzime në Mallra dhe Shërbime të tjera** (zëri 602), shuma e alokuar në buxhetin vjetor është përkatësisht 22.000.000 lekë, për periudhën 8-mujore të raportimit shuma e planit të thesarit është 14.866.666 lekë. Shuma e realizuar për periudhën 8-mujore të raportimit është 8.159.035 lekë ose 37% ndaj totalit të alokuar. ASPA mund të mbledhë të ardhura deri në vlerën 2.000.000 lekë (kapitulli 05) nga tarifimi i trajnimeve, por ende nuk është bërë e mundur mbledhja e tyre.
- **Fondet për Transferta për Buxh. Fam. & Individ** (zëri 606) për periudhën 8-mujore të vitit 2023 janë shpenzuar 41.152 lekë ose 20% e buxhetit të alokuar për këtë zë.

Tabela e mëposhtme tregon realizimin e buxhetit, për të gjithë zërat për periudhën Janar-Gusht 2023.

**Tabela 1:** Shpenzimet totale sipas zërave të buxhetit

*në 000/lekë*

Emërtimi i zërave të Buxhetit		Buxheti Plan 2023	Plani i periudhës progresiv	Fakti 8- mujor 2023	Në %
<i>Paga (600)</i>		25.357	19.824	14.030	55.3%
<i>Sigurime Shoqërore (601)</i>		4.380		2.345	53.5%
<i>Mallra dhe Shërbime të Tjera (602)</i>	Kap. 01	22.000	14.867	8.159	37%
	Kap. 05	2.000	-	-	-

**SHKOLLA SHQIPTARE E ADMINISTRATËS PUBLIKE**

<i>Trans per Buxh. Fam. &amp; Individ (606)</i>	200	-	41	20%
<i>Kapitale te brendshme (231)</i>	2.000	2.000	0	0%
<i>Financime te huaja total</i>	-	-	-	-
<b><i>Totali</i></b>	<b>55.937</b>	<b>36.691</b>	<b>24.575</b>	<b>44%</b>

- ***Fondi për Investimet (zëri 231)***

Shkollës Shqiptare të Administratës Publike për vitin 2023, i është miratuar fondi 2.000.000 lekë për investime (zëri 231). Kjo vlerë është miratuar për projektin blerje pajisje kompjuterike/pajisje zyre me kod projekti 18AP601. ASPA ende nuk e ka shpenzuar këtë zë.

**Tabela 2:** Tabela e investimeve

<b>Emërtimi i projektit</b>	<b>Buxheti Plan për vitin 2023</b>	<b>Fakti 8-mujor për vitin 2023</b>	<b>Realizimi në %</b>
1. Blerje pajisje kompjuterike/pajisje zyre	2.000.000	0	0%

**Drejtore i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse**